



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Nr. 1945/11 Prot.

Tiranë, më 28.07.2025

**VENDIM**

Nr. 181, Datë 16.07.2025

**“PËR PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT TË PASURISË DHE  
FIGURËS SË KANDIDATIT PËR MAGJISTRAT PROKUROR, I CILI ËSHTË  
DIPLOMUAR NË SHKOLLËN E MAGJISTRATURËS NË VITIN AKADEMIK  
2024 - 2025, Z. LIXHERS MALI”**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, i përbërë nga:

|                    |                     |
|--------------------|---------------------|
| 1. Mirela BOGDANI  | Kryetar             |
| 2. Erind GERMENJI  | Zv/kryetar          |
| 3. Sokol STOJANI   | Anëtar              |
| 4. Zeqir HODA      | Anëtar (në mungesë) |
| 5. Arta MANDRO     | Anëtar              |
| 6. Ledina RIZA     | Anëtar              |
| 7. Moisi DUDA      | Anëtar (në mungesë) |
| 8. Vatë STAKA      | Anëtar (në mungesë) |
| 9. Olger EMINAJ    | Anëtar              |
| 10. Erind MERKURI  | Anëtar              |
| 11. Erion FEJZULLA | Anëtar              |

në mbledhjen plenare të datës 16.07.2025, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenet 159-161, 164 dhe vijues të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar dhe në nenet 18 dhe vijues, të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, shqyrtoi çështjen me objekt:

**“Për përfundimin e procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës së kandidatit për  
magjistrat prokuror, i cili është diplomuar në Shkollën e Magjistraturës në vitin  
akademik 2024 - 2025, z. Lixhers Mali”**

**KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË:**

Pasi mori në shqyrtim Relacionin shoqërues nr. 1945, datë 09.07.2025, të Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale, pasi dëgjoi relatorin Olger Eminaj si dhe diskutimet e zhvilluara në mbledhje plenare mbi çështjen,

## V Ë R E N:

1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë (*në vijim, Këshilli*) garanton pavarësinë, llogaridhënien, disiplinën, statusin dhe karrierën e prokurorëve.
2. Me Vendimin Nr. 24, datë. 13.02.2025, "*Për fillimin e procedurave të verifikimit të pasurisë dhe figurës për magistratë prokurorë, të cilët do të diplomohen nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2025*", Këshilli ka filluar procedurën administrative për verifikimin e pasurisë dhe figurës për 26 (njëzetë e gjashtë) kandidatë prokurorë të cilët do të diplomohen nga Shkolla e Magjistraturës, në vitin 2025, ndër të cilët edhe kandidati Lixhers Mali.
3. Me Vendimin nr.25, datë 13.02.2025, për "*Hedhjen e shortit dhe caktimin e relatorit për verifikimin e pasurisë dhe figurës për 26 (njëzet e gjashtë) kandidatët për magistratë prokurorë, të cilët mund të diplomohen nga Shkolla e Magjistraturës në vitin akademik 2025*", Këshilli zhvilloi procedurën e hedhjes së shortit për caktimin e relatorit, për secilin kandidat.
4. Relatori për kandidatin Lixhers Mali, z. Olger Eminaj në zbatim të Pikës 1, të Seksionit A, të Kreut VI, të Rregullores, në rrugë elektronike (*me e-mail*) me datë 18.02.2025 ka njoftuar kandidatin për fillimin e procedurës së verifikimit, si dhe për të drejtën për të kërkuar përjashtimin e relatorit, apo ndonjë anëtar të Këshillit, në rast të ekzistencës së një situatë konflikti interesi.
5. Njëkohësisht, kandidatit i janë dërguar formularët përkatës sipas kërkesave të ligjit duke i kërkuar plotësimin dhe dorëzimin e tyre së bashku me Autorizimet për verifikim pranë çdo personi fizik ose juridik, publik ose privat, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, të të dhënave personale që lidhen me verifikimin e figurës dhe pasurisë si dhe përpunimin e këtyre të dhënave kudo ku ato janë të regjistruara nga Këshilli.
6. Në datë 25.02.2025, protokolluar me nr. 370, kandidati Z. Lixhers Mali ka depozituar pranë Këshillit si më poshtë:
  - i. *Autorizimi për Këshillit të Lartë të Prokurorisë me qëllim sigurimin dhe verifikimin e të dhënave personale;*
  - ii. *Deklaratë me të dhënat mbi adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktet telefonike për njoftim gjatë kësaj procedure;*
  - iii. *Deklaratë mbi papajtueshmërinë me funksionin e magistratit për shkak të anëtarësisë në parti politike;*
  - iv. *Deklaratë Individuale që kandidati nuk është bashkëpunëtor, informator ose agjent i shërbimeve sekrete;*
  - v. *Formular Vetëdeklarimi për zbatimin e Ligjit 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike";*



e Përgjithshme të Tatimeve (DPT), Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSH), Qendra Kombëtare të Biznesit (QKB), Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (DPD), Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP), Drejtoria e Përgjithshme Detare (DPD). Ky kontroll është kryer për periudhën 30.06.2022 - 10.03.2025.

14. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera në përputhje me Ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publik” i ndryshuar, Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, si dhe Ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, është konstatuar se, për kandidatin Lixhers Mali,
- a. deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
  - b. ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë;
  - c. nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
  - d. nuk ka kryer deklarim të rremë;
  - e. nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.
15. Në përgjigje të kërkesës së Këshillit, Agjencia e Inteligjencës Financiare informon se, *“Pas kërkimeve në sistemin elektronik, për kandidatin Lixhers Mali nuk disponohen të dhëna për transaksione apo pasuri të dyshimta”*.
16. Në përgjigje të kërkesës së Këshillit, me shkresën nr. 4224/1 prot, datë 25.03.2025, të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve është kthyer përgjigje, në të cilën informohet se: *“Shtetasi Lixhers Mali nuk figuron e regjistruar në organet tatimore për ushtrim të ndonjë aktiviteti privat”*.
17. Në përgjigje të kërkesës së Këshillit, me shkresën nr. 5125/1 prot, datë 21.03.2025, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ka informuar se, nga verifikimet e kryera në sistemin elektronik të administrimit të të dhënave “Asycuda World” ka rezultuar që, shtetasi Lixhers Mali *“nuk ka kryer ndonjë veprim doganor import-eksporti. Gjithashtu, nuk rezultojnë deklarime të bëra për para CASH, çek, apo metale a sende të çmuara në pikat e kalimit kufitar doganor për periudhën Mars 2004 deri më 18 Mars 2025”*.
18. Në përgjigje të kërkesës së Këshillit, me shkresën nr. 3160 prot, datë 20.03.2025 të ISSH, është dërguar informacion i cili disponon të dhëna për kontributet të cilat mbliidhen dhe dërgohen nga drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nëpërmjet Webservice sipas formularit standart përkatës (formulari përmban të dhëna për pagën dhe derdhjen e kontributit të sigurimeve shëndetësore për periudhën Qershor 2022-Shtatot 2022).
19. Në përgjigje të kërkesës së Këshillit, me shkresën nr. 5254/1 prot, datë 13.03.2025 të QKB, është dërguar informacion, se shtetasi Lixhers Mali *nuk figuron të jetë paisur*

me NUIS (NIPT), si peron fizik, juridik apo të zotërojë kuota/aksione në shoqëri tregtare të regjistruara pranë Regjistrisë Tregtare.

20. Nga përgjigjet e ardhura nga këto institucione arrijmë në përfundimin se, ka rezultuar përputhshmëri mes deklarimeve të kandidatit të kontrolluar, Aktit të përgatitur nga ILDKPKI-ja si dhe përgjigjeve të ardhura nga institucionet e mësipërme. Në këtë mënyrë, është konkluduar se, nuk ka nevojë të kryhet hetim më i thelluar se ai i kryer nga ILDKPKI-ja.

#### B. VERIFIKIMI I FIGURËS SË KANDIDATIT

21. Mbi bazën e Formularit të Vetëdeklarimit për zbatimin e Ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", kandidati Lixhers Mali rezultoi se:

-nuk ka qenë e dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga ndonjë autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj;

-nuk është e dënuar me burgim me vendim gjyqësor jopërfundimtar nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj, për një çështje penale të pazgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë;

- nuk ka qenë ndonjëherë nën hetim ose gjykim nga një autoritet i huaj për kryerjen e një vepre penale;

-nuk është e dënuar me burgim me vendim gjyqësor jopërfundimtar nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj, për një çështje penale të pazgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë;

- nuk ka qenë ndonjëherë nën hetim ose gjykim nga një autoritet i huaj për kryerjen e një vepre penale;

-nuk ka qenë e ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese, për kryerjen e një vepre penale;

-nuk është caktuar ndaj saj ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale, në fuqi ose jo;

-nuk është lëshuar ndonjëherë ndaj saj një urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e veprave penale;

- nuk është marrë ndaj saj masa e dëbimit nga një shtet i huaj;

- nuk ka jetuar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë,

22. Në përgjigje të kërkesës së Këshillit, me shkresën nr. 407/3 prot, datë 20.03.2025, Prokuroria e Përgjithshme informon se: Nga verifikimet në sektorin e protokoll arkivit sekret rezultoi se, në emër të shtetasit Lixhers Mali "nuk disponohen të dhëna apo indicje që çenojnë figurën e kandidatit. Gjithashtu rezultoi se nuk ka çështje penale, kallëzim apo ankesa ndaj tij".



23. Në përgjigje të kërkesës së Këshillit, me shkresën nr. 9834 prot. (DB), datë 20.03.2025, Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar konfirmon se pas verifikimeve të kryera në regjistrin e njoftimit të veprave penale të kësaj prokurorie, *“nuk rezulton të jetë regjistruar ndonjë procedim penal në emër të shtetasit Lixhers Mali, për periudhën 01.07.2022 deri aktualisht”*.
24. Në përgjigje të kërkesës së Këshillit, Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë, Berat, Gjirokastrë, Dibër, Tiranë, Durrës, Korçë, Fier, Elbasan, Vlorë, Shkodër, Lezhë, Kukës, Sarandë, informojnë se, *“Për shtetasin Lixhers Mali nuk disponojnë të dhëna, apo indicje të ardhura nga agjencitë ligjzbatuese, të dhëna për kontakte me persona të papërshtatshëm, apo materiale kallëzuese të mosfilluara, procedime penale të pushuara, pezulluara apo të dërguara për gjykim”*.
25. Në përgjigje të kërkesës së Këshillit, Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm me shkresën nr. 85/1, datë 17.03.2025 dhe Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, Gjirokastrë, Dibër, Tiranë, Durrës, Korçë, Fier, Elbasan, Vlorë, Shkodër, Lezhë, Kukës, Sarandë, në përgjigje të shkresave të dërguara nga KLP, informojnë se, *“Për shtetasin Lixhers Mali nuk rezultojnë çështje penale, urdhër mbrojtje ose urdhër mbrojtje të menjëhershëm”*.
26. Në përgjigje të kërkesës së Këshillit, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me shkresën nr. 475/1, datë 17.03.2025 dhe Gjykatat e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me shkresën nr. 1072/1 prot, datë 01.04.2025, informon se, *“Për shtetasin Lixhers Mali nuk rezultojnë të ketë proces gjyqësor penal në ngarkim dhe kjo gjykatë nuk ka dhënë ndonjë vendim penal”*.

• **Raportimi nga organet e specializuara**

27. Gjatë procedurës së verifikimit të figurës për kandidatin Lixhers Mali ju kërkuar informacion shërbimeve informative si: Shërbimi Informativ Shtetëror, Agjencia e Mbikëqyrjes Policore, pranë Ministrisë së Brendshme, Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes pranë Ministrisë së Mbrojtjes dhe Byroja Kombëtare e Hetimit për kandidatin Lixhers Mali.
28. Me shkresat e dërguara nga Shërbimi Informativ Shtetëror, Agjencia e Mbikëqyrjes Policore pranë Ministrisë së Brendshme, Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes pranë Ministrisë së Mbrojtjes dhe Byroja Kombëtare e Hetimit, informohet se, *për kandidatin Lixhers Mali,*
- *Nuk disponohen të dhëna për përfshirje në veprimtari të kundërligjshme,*
  - *Nuk ka të dhëna për veprimtari kriminale apo të ketë lidhje/kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar,*
  - *Nuk disponohen të dhëna/informacione për përfshirjen e tij në veprimtari që çenojnë sigurinë kombëtare apo aktivitete të kundërligjshme.*



29. Referuar Deklaratës së datë 25.02.2025, mbi papajtueshmërinë me funksionin e magjistratit për shkak të anëtarësisë në parti politike, kandidati Lixhers Mali ka deklaruar se, nuk është anëtar në ndonjë parti politike, pasi kjo përbën shkak papajtueshmërie me funksionin e magjistratit. Kjo deklaratë është lëshuar me përgjegjësi ligjore sipas nenit 6, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
30. Në përgjigje të kërkesës së Këshillit, me shkresën nr. 2130 prot, datë 15.04.2025, Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar ka informuar se *“nuk, disponohen të dhëna për përfshirjen e z. Lixhers Mali në veprimtari që çënojnë sigurinë kombëtare apo aktivitete të kundraligjshme”*.
31. Në përgjigje të kërkesës së Këshillit, me shkresën nr. 438/1 prot, datë 26.03.2025, Shkolla e Magjistraturës informon se kandidati Lixhers Mali *“nuk ka masë disiplinore në fuqi dhe ndaj saj nuk ka ndonjë proces disiplinor”*.
32. Relacioni paraprak i vlerësimit ju dërgua për njohje në rrugë elektronike kandidatit Lixhers Mali me datë 03.07.2025, e cila në përgjigjen e tij po në rrugë elektronike me e-mail me datë 03.07.2025, shprehu dakordësinë pa vërejtje në lidhje me gjetjet e Raportit.
33. Përsa më sipër, Këshilli vlerëson të përfunduar procedurën e verifikimit të pasurisë dhe figurës së kandidatit për magjistrat prokuror, i cili është diplomuar në Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2024-2025, z. Lixhers Mali.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 149/a, pika 1, germa “a”, të Kushtetutës, në nenet 32 dhe 35, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në nenet 159 dhe 189 pika 1, germa “a”, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në Vendimin nr. 171, datë 29.09.2019, “Për miratimin e “Rregullores për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin, emërimin si magjistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe zhvillimin e karrierës së prokurorëve”, e ndryshuar, me propozim të Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale sipas Relacionit nr. 1945, datë 09.07.2025, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

#### **V E N D O S I:**

1. Të vlerësojë të përfunduar procedurën e verifikimit të pasurisë dhe figurës të kandidatit për magjistrat prokuror, i cili është diplomuar në Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2024-2025, z. Lixhers Mali.
2. Lejimin e kandidatit Lixhers Mali, të vijojë me procedurat e mëtejshme për emërimin e tij si prokuror.

ETAKIA-ES

3. Të njoftohet për këtë vendim Shkolla e Magistraturës dhe z. Lixhers Mali.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

U shpall në Tiranë, sot më 16.07.2025.



**KRYETAR**  
**Mirela Bogdani**

**ANËTAR**  
**Sokol Stojani**



**ANËTAR**  
**Olger Eminaj**

**ANËTAR**  
**Arta Mandro**

**ANËTAR**  
**Erind Merkuri**

**ZV/KRYETAR**  
**Erind Germenji**

**ANËTAR**  
**Ledina Riza**

**ANËTAR**  
**Erion Fejzulla**